

RAPORTI MBI VËZHGIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2016

Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional (QMBI), në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që u mbajtën më 11 dhjetor 2016, ishte vëzhguese e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve. Mbikëqyrja u realizua përmes përcaktimit të aktivistëve/anëtarëve tanë në disa qytete të Republikës së Maqedonisë, edhe atë: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër dhe Dollnen. Nga qëllimet tona kryesore me këtë rast, ishte dhënia e kontributit pozitiv si organizatë joqeveritare në mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve, në drejtim të respektimit të vullnetit dhe votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Po ashtu, edhe pajisja jonë dhe anëtarëve tanë me një përvojë të re të kësaj natyre, përmes përcjelljes së drejtpërdrejtë të procesit zgjedhor.

Me autorizim nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, kemi pasur vëzhgues në 3 nivelet: 1 vëzhgues në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, 5 vëzhgues në Komisionet komunale zgjedhore dhe 38 vëzhgues në Këshillat zgjedhorë.

Me qëllim të njoftimit të vëzhguesve tanë me të drejtat dhe obligimet e tyre, realizuam dy trajnime, me ç'rast u kërkua prej tyre edhe respektimi i rregullativës zgjedhore dhe kryerja e detyrës me përgjegjësi dhe korrektësi.

Po ashtu, tre ditë para zgjedhjeve, përmes mjeteve të komunikimit publik, QMBI bëri apel për një proces zgjedhor të lirë, fer dhe demokratik.

Procesi zgjedhor në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve u ndoq edhe përmes prononcimeve tona, të cilat u realizuan në orë të caktuara, edhe atë: i pari në ora 12⁰⁰, i dyti në ora 16⁰⁰, ndërsa i treti në ora 19⁰⁰. Këto prononcime u bënë në bazë të dhënave që kishim deri në ato kohë nga vëzhguesit tanë të stacionuar nëpër vendvotime, në komisionet komunale, si dhe në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

Sipas vëzhguesve tanë, procesi i votimit ka filluar kryesisht në kohën e paraparë me ligj, pra me hapjen e kutive të votimit në ora 7⁰⁰ të mëngjesit, me përjashtim të disa vendvotimeve, edhe atë:

- Vendvotimi nr. 2341/1, Sh.F. "Naim Frashëri", fsh. Studeniçan, vonesë prej 6 minutave;
- Vendvotimi nr. 2887, Sh.F. "7 Marsi", Çair, vonesë prej 7 minutave;
- Vendvotimi nr. 2348, Sh.F. "Naim Frashëri", fsh. Moranë, vonesë prej 10 minutave;
- Vendvotimi nr. 1036, Poliklinika "Tode Mendoll", Kumanovë, vonesë prej 15 minutave;
- Vendvotimi nr.1125/1, Sh.F. "Faik Konica", fsh. Sllupçan, vonesë prej 17 minutave;
- Vendvotimi nr. 2452/1, Sh.F. "Bajram Shabani", fsh. Kondovë, vonesë prej 30 minutave.

Në përgjithësi, sipas të dhënave të grumbulluara nga ana e vëzhguesve tanë, mund të konstatojmë se procesi i votimit ka kaluar kryesisht në atmosferë të qetë e demokratike, pa incidente të theksuara.

Megjithatë, edhe gjatë këtij procesi zgjedhor nuk kanë munguar parregullsitë, disa prej të cilave janë shënuar edhe nga vëzhguesit tanë, edhe atë:

Shkup:

- Vendvotimi nr. 2887, Sh.F. "7 Marsi", Çair: Këshilli zgjedhor nuk ka qenë i informuar mirë rreth procesit zgjedhor. U është thënë disa qytetarëve se nuk janë në listën zgjedhore, por pas insistimit të tyre dhe kontrollimit të dytë në listën zgjedhore, është vërtetuar se të njëjtit kanë qenë të regjistruar në këto lista. Po ashtu, në të njëjtin vendvotim, gjatë dhënies së ndihmës dy personave me nevoja të veçanta, krijohet panik në vendvotim, në momentin kur aty ka pasur mbi 15 qytetarë duke pritur për të votuar. Si pasojë e revoltës dhe fjalosjes, dy qytetarë refuzojnë të votojnë dhe lëshojnë vendvotimin. Njëri prej tyre, edhe pse është evidentuar dhe ka nënshkruar në listën zgjedhore, nuk e merr fletën e votimit dhe refuzon të votojë.
- Vendvotimi nr. 2890, Sh.F. "Liria", Çair: Është evidentuar agjirim për një parti politike.
- Vendvotimi nr. 2503/1, F. "Krste Misirkov", Shkup: Mospërgatitje adekuate e këshillit zgjedhor, mosdijeni për rrjedhën e përgatitjes së materialit zgjedhor; mungesë e procesverbaleve për vëzhguesit e OJQ-ve.
- Vendvotimi nr. 2452/1, Sh.F. "Bajram Shabani", fsh. Kondovë: Është regjistruar një rast i votimit familjar.
- Vendvotimi nr. 2447/1, fsh. Llaskarcë: Largim me forcë i vëzhguesit tonë nga vendvotimi; tentim për mbushje të kutive.

Gostivar:

- Vendvotimi nr. 410: Komisioni nuk ka kontrolluar si duhet personat në listën zgjedhore, megjithëse pas kontrollit në KSHZ të njëjtit gjenden.
- Në disa vendvotime në shkollën e mesme teknike në Gostivar ka pasur problem me marrjen e materialit zgjedhor.
- Në fshatin Llakavicë, vendvotimi nr. 520, është vërejtur agjitacion nga disa persona.
- Në shumë vendvotime është vërejtur mungesë e qytetarëve në listat zgjedhore.

Tetovë:

- Vendvotimi nr. 1928, Sh.F. "Naim Frashëri", Tetovë: Një person ka fotografuar fletën e votimit, ndërsa me kërkesë të kryetarit të këshillit zgjedhor, ndërhyu policia dhe arreston personin në fjalë.
- Janë paraqitur shumë ankesa nga qytetarë se nuk janë në listat zgjedhore.

Kumanovë:

- Vendvotimi nr. 1040/1, Sh.F. "Naim Frashëri": Anëtari i këshillit zgjedhor sugjeron votuesit të votojnë parti të caktuar politike.
- Vendvotimi nr. 1125/1, Sh.F. "Faik Konica", Sllupçan: Votues mungojnë në listën zgjedhore; herë pas here vërehet votim familjar.
- Vendvotimi nr. 1126, Sh.F. "Faik Konica", fsh. Sllupçan: Problem me llambën kontrolluese dhe disa raste të votimit për dikë tjetër.

Në përgjithësi, vërejtjet tona do t'i kishim përmbledhur si vijon:

- Vonesa të fillimit të procesit të votimit;
- Manipulime të këshillave zgjedhore me qytetarët, duke u thënë se nuk janë në listën zgjedhore, e pastaj të vërtetohet se ata janë aty;
- Votim familjar;

- Agjtim për parti të caktuara politike;
- Fotografim i fletëvotimit;
- Mungesë e materialit zgjedhor;
- Shkelje e fshehtësisë së votimit;
- Mosnjohje e rregullativës zgjedhore, që ka të bëjë me procesin e votimit, nga ana e këshillave zgjedhorë në disa vendvotime;
- Një rast i përzënies së vëzhguesit tonë nga vendvotimi;
- Mospranim i sugjerimeve të vëzhguesve tanë për lëshimet dhe parregullësitë gjatë procesit të votimit, nga ana e këshillave zgjedhorë.

PËRFITIMI NGA VËZHGIMI I PROCESIT ZGJEDHOR:

E para, shpresojmë të kemi dhënë një kontribut modest në mbarëvajtjen e procesit të votimit dhe respektimit të vullnetit të lirë të qytetarëve në vendvotimet ku kishim vëzhguesit tanë, duke e kryer punën e tyre me përgjegjësi dhe korrektësi maksimale.

E dyta, besojmë që kjo të jetë një përvojë e re pozitive edhe për neve si organizatë joqeveritare, meqë ishte hera e parë të veprojmë në rolin e vëzhguesit të një procesi zgjedhor në vend, duke na hapur kështu rrugë e mundësi për të luajtur një rol edhe më të madh dhe më të rëndësishëm në këtë drejtim në të ardhmen.